



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

01/856
16.03.2023



KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dyte e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 16.02.2023, me fillim nga ora 11:00.
Në takim morën pjesë: Kryetarja e Kuvendit Mirjana Simijonović, anëtarët e KPF-së: Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanović, Abdyl Gashi, Drejtori i Financave z. Millosh Denić, dhe përfaqësuesi i OSBE-së z. Edmond Hyseni.
Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet të vendoset kuorumi, të pranishëm janë 4 anëtarë të KPF-së, deklaroj se ka kuorum për punë dhe seancën e filloj me këtë:

Rendi i ditës

1. Miratimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Fundit e KPF-së;
2. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Orarit të Mbledhjeve të Kuvendit;
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit për vitin 2023;
4. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Raportit Tremujor Financiar, Tetor-Dhjetor;
5. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Raportit Financiar për vitin 2022;
6. Të ndryshme.

Kryetarja pyeti të pranishmit nëse janë dakord me këtë rend dite apo kanë ndonjë sugjerim tjetër.

Pranvera Gashi Kastrati tha unë kam një propozim që ta ftoj Komisionin ose Kryesuesin e komisionit për emrimin e rrugëve që të na jep një sqarim se deri ku kanë shkuar punët në këtë komision pasi që edhe unë kam qënë antare e këtij komisioni dhe e di se është bërë një punë e mirë dhe ka qënë thuajse e përfunduar puna e komisionit pra ta ftoj në kuvend të raportoj të jetë si pikë e veçantë për mbledhjen e kuvendit;

Kryesuesja; ne e kemi pasur në rend të ditës këtë pikë por e kemi tërhequr nga se komisioni i ka kërkuar që ti jepet edhe pak kohë për arsye se po presin konfirmimin nga prishitina pasi që i kanë dorëzuar të gjitha emrat e rrugëve në prishitinë e deri sa mos të vije raporti nga prishitina raporti i komisionit është i pa kompletuar, por gjithsesi ne mund ta diskutojmë në kuvend të rendit të ditës të pikat të ndryshme edhe po të siguroj se unë personalisht do të bisedoj edhe një herë me kryetarin e komisionit se a ju ka kthyer raporti nga prishitina e nëse ju ka kthyer ne do ta diskutojmë, kryesuesja a kemi tjetër propozim për reditë nëse jo e hedhim në votim për miratim të rendit të ditës, kush është por për këtë rend dite, konstatoj se nga 4 antarë që janë prezent këta janë pro.

Pika e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e KPF-së;

Kryetarja hap diskutimin për këtë pikë.

Meqenëse nuk ka pasur diskutime, procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua njëzëri nga anëtarët e KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe Aprovimi i Orarit të mbledhjeve të Kuvendit;

Kryesuesi tha se me kohë e kemi marrur materialin dhe në material kemi edhe orarin e mbledhjeve të kuvendit dhe kemi pasur kohë të mjaftueshme që ta shqyrtoni, jemi munduar që mbledhjet e Kuvendit të jenë në ditët e punës e jo ditë vikendi dhe po ashtu jemi munduar që mbledhjet mos të jenë në datat kur janë festat si shtetërore si ato fetare, po ashtu i

Zapisnik KPF-a

kemi dhanë me shumë hapsir Administrates së Kuvendit që të kenë kohë per pregaditje të materjalit pra qe ti kenë me shumë se shtatë ditë pune kohë per pregaditje te materjalit .
nese keni ndonje vrejte apo sygjerim ju japë fjalen per diskutim.
Pranvera Gashi Kastrati:unë kisha dashur që mbledhja të mbahet ashtu siq ka qen në orarin e vitit te kaluar pra te mbahet në ora 10h e jo siq është tash prej ores 11h,per shumë arsye.
Kryesusja; e kemi ndrruar oren e mbajtjes së takimit per arsye se kam manduar që administrates së kuvendit ti jepet kohë ma shum per qka do qoft per pregaditje te materajlit per ket arsye,po nese ka nevoj per ndonje materjal shtes te kem nje orë me shum per pregaditje të materjalit.
A ka dikush tjetër të shtoj diqka nese nuk ka atëhere e qes ne votim kush është per qe koj pik e rendit të dites te shkoj në kuvend.
Kryesusja ;konstatoj se nga 4 te pranishmit 4 janë pro qe kjo pik të shkoj në kuvend.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Raportit të Punes së Kuvendit per vitin 2022.

Kryesusja;Materjalin e keni marrur me kohë dhe se e keni par edhe ju se kemi pasur shumë aktivitete në vitin 2022 po ashtu në Raport e shiheni se sa vendime kemi marrur gjat vitit 2022 dhe sa i perket vendimeve 90% kemi votuar anonimisht të gjitha vendimet pra shumicen e vendimeve i kemi pruar se bashku,mund të kthemi se se bashku me administraten e kuvendit jemi munduar që ti cekum të gjitha aktivitetet dhe gjithashtu kemi pasur kujdes që te gjitha vendimet të jen ne perputhje me ligjet në fuqi e si deshmi kemi se nga ministria e pushtetit lokal janë kthyer dy ose tri vendime edhe ate per gabime teknike e edhe nje here po them se asht shum e rendesishme se edhe para ministrive edhe para qytetarve jemi duke punuar në harmoni me ligjet në fuqi,po e hapi diskutimin nese ka dikush të marr fjalen urdheroni.
Nese nuk ka kerkush të diskutoj kush është për që kjo pik të shkoj në kuvend.
konstatoj se nka 4 antar prezent 4 janë pro dhe konstatoj se edhe kjo pik shkon në shyrtim në mbledhjen e kuvendit.
Propozoj që te kalojm në piken e katert.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe Aprovimi i Raportit Tremujor Financiar,Tetor-Dhjetor 2022,
Kryesusja; per këtë Pikë kemi propozuesin e kesaj pike dhe ja jap fjalen drejtorit të financave zt.Milos Denic urdhero zt.Drejtor fjala është per ty:Filimisht me lejoni të ju pershendes të gjithë te pranishmit në mbledhjen e KPF-së dhe ju kerkoj falje se materjali ju ka ardhur me vones po shpresoj se deri në mbledhjen e kuvendit do të keni kohë që ta analizoni ,bëhet fjale per raportib e tre mujorit të fundit të vitit 2022 pra muajve Tetor –Dhjetor,kisha dashur ti permendi si pershembull të hyrat që janë inkasu gjat keti viti në tabelen nr 2 keni të hyrat që janë ralizu ku ashtë suma mbi 109 mi euro mund ti shiheni edhe në kode ekonomike ,po ashtu shiqoni në fund të tabelës ku kemi edhe një participim ku qytetaret kanë parcitipu me 30% të shumes kur janë shpernda mjetet bujqesore e në fund të hyrat dalin mbi 133 mi euro. në bazë te keti raporti kemi edhe shpenzimet qe i kemi pasur gjatë keti tre mujori ku ne katekorin per paga dhe meditje kemi:mbi 600 mi euro,në kodin ekonomik mallra dhe sherbime mbi 179mi euro,sherbime komunale 31 mi euro,në subvencione 117 mi euro dhe në fund investime kapitale kemi mbi 300 mi investime kapitale të gjitha keto shpenzime qe i kemi pasur mund ti shiheni edhe ne tabela tjera te ndara sipas kategorive ekonomike faleminderit nese ka dikush të pys jam i hapur urdheroni.
Kryesusje:faleminderit drejtor sa i perket kti materjali të pikes Kater dhe Pes neve në administraten e Kuvendit dje na ka ardhur ky materjal dhe sot ne ju kemi shperndar po besoj deri në kohen kur do të mbahet mbledhja e kuvendit që është me daten 28.02.2022 do të keni kohë qe ta shqyrtoni dhe analizoni e qe komentet do ti japim në mbledhje të kuvendit.
A ka dikush që deshiron të thotë.nese jo atëher e qesim në votim kush është pro qe kjo pik të shkoj në kuvend.
konstatoj se nga kater të pranishemit kater votuan pro.
shkojm në piken e pest të rendit të dites :

Pika e pestë:Shqyrtimi dhe Aprovimi i raportit Financiar per vitin 2022.

Kryesusja: sa i perket kesaj pike unë në emer të administrates komunale ju kerkoj falje se siq e ceka edhe me lart dje ne kemi marrur materjalin nga drejtoria dhe nuk ju ka ardhur me kohë por per mbledhje të kuvendit do ta keni me kohë materjalin ,edhe per këtë pikë te rendit të dites ja jap fjalen drejtorit të drejtoris per Financa zt.Denic urdhero zt.Drejtor këtë Raport Financiar Vjetor është formë standarte keshtu në këtë form e punojnë të gjitha komunat e kosoves dhe pregaditet deri në fund të janarit e pastaj dergohet në ministrin e financave siq shihet apo edhe e keni par edhe ma heret është një raport ma kompleks andaj edhe kerkon punë ma shumë është punë me e rend ma e veshtir ma prefesionale dhe

kerkonë kohë me shumë per tu kryer do te kisha filluar nga faqja nr 4 neni 14 dhe ta prezentojm buxhetin final të vitit 2022 ku të hyra kemi pasur të planifikuara 274 mi euro ndersa të ralizuera kemi pasur 390mi euro.në kodin per paga dhe meditje kemi pasur 2 milion e 125mi euro,në kodin per mallra dhe sherbime kemi pasur 325 mi euro,shpenzime komunale kemi pasur 85 mi euro,transferd dhe subvencione kanë qen 261 mi euro dhe shpenzime kapitale janë 575 mi euro në anan e majt në tabel janë cek edhe ralizimi i tyre i keni aty në tabel per Paga dhe meditje investime kapitale,transfere dhe subvencione pra keshtu vazhdon në qdi katekori shiqone tabelen pra që mos ti lexoj të gjitha .pra prej faqes 9 e knena i keni në tabela ,në faqen 13 kemi të hyrat tatimore ku kemi grumbulluat mbi 133mi euro tatim në pronë ndersa në tabelen me posht janë praqit tatimet jo tatimore gjegjesisht jo tatimi i pasuris se pa tundshme,gjithashtu kemi e dhe mjetet e grumbulluara nga policia dhe Sektori i pylltaris në faqen 22 janë te paraqitura keto mjete të grumbulluara mbi 219 mi euro janë mjete të bartura nga viti i kaluar si mjete vetanake,455mi kanë qenë të hyra per vitin 2022 dhe keshtu në vitin e kalum kemi pasur mbi 660 mi euro të hyra vetanake,në vitin e kaluar kemi shpenzuar mbi 370 mi euro keshtu qe na kan mbetur 290 mi euro qe ti bartim per vitin 2023 ketu janë te paraqitura edhe investimet e donatorve jasht komune në faqen nr 15,do të mundohem ti paraqes edhe tabelat tjera e ju krahasoni ,në faqen 16 dhe 17 i kemi raportin gjegjesisht kerkesave të komunes ku janë në pytje 634 mi euro,në faqen 19 i keni tabelat ku i kemi paraqitur të gjitha obligimet e komunes që na kanë mbetur nga viti paraprak e qe do ti paguaj në vitin 2023 e më se shumti borgj kemi të subvencionet ku nuk kemi aritur ti perfundojm gjat vitit 2022,i kemi të parapara edhe shpenzimet potenciale ose shpenzimet e mundshme qe do ti kemi ketu behet fjal per paqit që janë ngrit ndaj komunes,dhe në faqen 20 pra krejt në fund është tabela ku janë paraqitur shpenzimet kapitale në vler mbi 1 mi euro,mund te shiheni dalimin nga viti 2021 në vitin 2022 në vitin 2021 i kemi pasur 2 milion të regjistruar pasuri komunale ndersa vlera e vitit 2022 është 57 milion pasuri komunale e rexhistruar ,pasi komisioni per rexhistrimin e prones komunale e ka punuar punen siq duhet por kjo vler do të shkoj duke u rritur pasi qe komisioni ende nuk e ka kryer punen e pasi ta kryej gjith regjistrimin komisioni ne ahëhere do ta dim se sa është vlera e pasuris së komunes.ju faleminderit me falni qe e zgjata pak,

kryesuesja;faleminderit drejtor siq raportuar pasmi lajme mjaft e mira,se po shihet qe keto komisione që janë formuar edhe nga ana e kuvendit po ashtu edhe e ekzekutivit po deshmojn së është punuar, e hapi diskutimin nese dikush nga koleget ka per të thënë diqka jurdheroni ja jap fjalen,atëhere nese nuk ka kerkush të diskutoj e qes në votim piken pes kush është për qe edhe kjo pik të shkoj në diskutim në Kuvend.

konstatoj se nga 4 të pranishem kater janë pro qe edhe kjo pik të shkoj në kuvend.

kalojm në piken e **gjasht të Ndryshme** :a ka dikush që deshiron të flas, nese ska atëhere e deklaroj të mbyllur mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa ju faleminderit per pjesmarrje e shihemi në mbledhjen e kuvendit.

Takimi ka përfunduar në orën 11:30.

Procesmbajtëse
Sylejman Avdyli



Kryesuesja Kuvendit
Mirjana Simijonović

